# DËSHMI ARKIVI

**A-469094**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Më goditi me pasqyrë, duke më rrezikuar jetën”/ Rrëfimi i shefit të Komisariatit të Krujës për videon viral e ku u përfshi |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/25/me-goditi-me-pasqyre-duke-me-rrezikuar-jeten-rrefimi-i-shefit-te-komisariatit-te-krujes-per-videon-virale-ku-u-perfshi/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 13:55:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 13:43:05 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0db9b6a4141fb699e281a963d0bdfa2cb69417deaea93ecef9c42692fceff490` |
| TEKSTI | `2330a8432c86bab74b3b942430ab14d609cb463b4b70948eb20358bcf1d90611` |
| PAMJA | `50e3e446b04450f55b98e57ae0bdcf8471c4e9519ff0823431dc4964daeb10fc` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9272b97f60a64a20ad5943d1d5d69a1758dcbc5af5d4a4fef7f12f41deea7f35` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9272b97f60a64a20ad5943d1d5d69a1758dcbc5af5d4a4fef7f12f41deea7f35`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Më goditi me pasqyrë, duke më rrezikuar jetën"/ Rrëfimi i shefit të Komisariatit të Krujës për videon virale ku u përfshi

Aktualitet

Publikuar: 25/09/2026



Shefi i Komisariatit të Policisë së Krujës, Elton Shahini, ka reaguar për Top Channel lidhur me incidentin ku u përfshi në ditët e fundit të korrikut 2026, pamjet e të cilit u bënë virale gjatë ditës së sotme. Shahini ka dhënë versionin e tij për rrethanat dhe dinamikën e ngjarjes.

Shahini thotë se në momentin e ngjarjes ishte jashtë orarit të punës, ka qenë fundjavë dhe po udhëtonte me motor drejt plazhit, kur drejtuesi i një automjeti, i cili shfaqet edhe në video, sipas tij, kreu manovra të rrezikshme dhe e goditi me pasqyrën e makinës.

"*Ka qenë fundjavë, ditë pushimi zyrtare. Kam qenë duke shkuar në plazh, isha duke ecur me motor, isha në punën time. Në ato momente, shoferi që duket në video ka qenë duke ecur në mënyrë të papërgjegjshme në rrugë dhe bënte manovra të rrezikshme. Kur më ka kaluar pranë, më ka goditur me pasqyrë*", tha Shahini për Top Channel.

Sipas shefit të Komisariatit të Krujës, mes tij dhe drejtuesit të automjetit ka pasur më pas një përplasje verbale.

"*Më shau, e shava*", shprehet Shahini

Ai mohon se ka kërcënuar apo ka ushtruar dhunë fizike ndaj personit tjetër të përfshirë në incident.

"*Nuk e kam kërcënuar dhe as kam ushtruar dhunë fizike*", deklaroi ai.

Shahini thekson gjithashtu se, megjithëse ishte civil dhe jashtë orarit zyrtar të punës, nuk e përdori autoritetin e tij si drejtues i

Me te lexuarat


Shantazhi / Kryespiunia Vlora Hyseni filmoi politikanë dhe magjistratë me dashnoret në hotel, për...


Tedi Malaveci merr mandatin e radhës, përmbaruesit privatë i besojnë sërish drejtimin e Dhomës


FOTO/ U arrestua në Rusi, zbulohet portreti i Shpëtim Aliut! ('Kumbari' që furnizonte...


Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit


Skandali/ Shefin e Komisariatit të Fushë-Krujës Elton Shahinin e rrahin me shpulla në mes të rrug...

zyrtar të punës, nuk e përdori autoritetin e tij si drejtues i komisariatit të policisë së Krujës gjatë konfliktit.

"*Pavarësisht dhunës fizike dhe fyerjeve ndaj meje, në asnjë moment nuk kam përdorur autoritetin tim zyrtar, nuk kam kërcënuar me postin që mbaj dhe nuk jam përgjigjur me dhunë fizike*", tha shefi i Komisariatit të Krujës.

**/TCH**

**TAG:** Krujë | Me goditi me pasqyrë | shefi i komisariatit

## Të ngjashme




**Policia jep detaje për plagosjen me armë në Tiranë, 33-vjeçari u qëllua në këmbë (Emri)**




**Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb**



**Incidenti i Vlora Hysenit me gazetaren, Tabaku: Institucionet në shërbim të interesave personale, ky sistem duhet çmontuar**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.